



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.537/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Podujevës, Florie Besholli, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Podujevës, Florie Besholli, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjë ZL.A.nr.537/2017 e datë 27.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 27.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Podujevës, Florie Besholli, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën ka pretenduar se ka pasur manipulime me votat e qytetarëve në këto Qendra të Votimit: 1830e,1818e,1824e/04, 1833e, 1814e, 1802X, 1831e, 1820, 1821 e, 1805e, 1804C/02 dhe 01R.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Podujevës, Florie

Besholli, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.537/2017 më datën 31.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.